**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE**
***Drejtoria e Administrimit te Prones Publike***

**URDHER**

Nr. 447 Date 15.12.2004

**PER**

**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "UJESJELLESI" MALESI E MADHE**

Drejtuar : Sh.A. "UJESJELLESI" **MALESI E MADHE**

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe neni 128, 150 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, me cilesine e aksionerit te vetem ,

**URDHEROJ:**

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 1 780 000 leke, e barabarte me 1 780 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion, qe i perkasin vleres se sistemeve qe do te kalojne ne pronesi te Qverisjes Vendore.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Ujesjellesi" Malesi e Madhe, **behet 32 420 000 leke** i barabarte me 32 420 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
   Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e shoqerise per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE

ANASTAS ANGJELI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
*Drejtoria e Administrimit te Prones Publike*

# URDHER

Nr 213 Date 30.6.2004

## PER

## NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "UJESJELLESI " MALESI E MADHE

Drejtuar: Sh.A "UJESJELLESI" MALESI E MADHE

Me cilesine e aksionerit te vetem te sh.a "Ujesjellesi" Malesi e Madhe, ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002 , Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", si dhe Vendimit Nr. 81 date 12.02.2004 dhe Vendimit Nr. 173 date 26.03.2004 te Keshillit te Ministrave,

**URDHEROJ:**

1. Zvogelimin e kapitalit te Sh.A "Ujesjellesi" Malesi e Madhe, per sistemin 3, i cili do te kaloje ne Komunen Shkrel.
2. Eksperti Kontabel i Autorizuar Z. Artan Golemi te pergatise raportin perkates ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij urdheri Drejtoria e Sh. A. " Ujesjellesi " Malesi e Madhe.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

Anastas ANGJELI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E REGJISTRIMIT TE AKSIONEVE SH.A.
TIRANE

# *EKSTRAKTI I REGJISTRIT TE AKSIONEVE*

## SH.A. Ujësjellësi Malesi e Madhe - MALESI E MADHE

Gjëndja më datë ........................ **07.22.2016**
Kapitali themeltar ...................... **32.420.000 LEK**
Vlera nominale / aksion ............ **1.000 LEK**
Totali i Aksioneve ......................**32,420**
Numri i Aksionerëve ................. **1**
Numri i Aksioneve të mbetura .. **0**

Për QRA

ARDIATI MYSLIMAJ

Adresa: Rr. "George W. Bush" Nr.13
Kutia Postare: 7424 - Tiranë
Tel: ++355 / 4 / 233425
Fax / Modem: ++355 / 4 / 233442

Vendimi i Gjykatës: Nr.14253 Dt. 21/03/96
Kodi Fiskal: K314 22103G
Nr. Llogarisë: 0200 355
BKT Dega Nr.2 Tiranë

Numri i Aksionerëve : 1

Numri i faqeve: 2

| NR. | EMRI | ATESIA | MBIEMRI | LINDUR ME | VENDLINDJA | AKSIONE | % | ADRESA | QYTETI | RRETHI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BASHKIA | - | MALESI E MADHE | 01.01.2001 | MALESI E MADHE | 32,420 | 100.000% | - | MALESI E MADHE | MM |
| | | | | | TOTALI = | 32,420 | 100.000% | | | |

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEUT - 2018 -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA MALËSI E MADHE

# ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

# UJËSJELLES KANALIZIME MALËSI E MADHE

Nr 6285 Prot. Koplik, më 28.09.2018

## VENDIM

## I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TE ORTAKËVE

Sot me datë 28.09.2018 në seline e Shoqërisë "Ujësjëllës Kanalizime Malësi e Madhe" sh.a, u mblodh Asambleja e Përgjithshme me pjesmarrjen e 100% të kuotave të kapitalit.

Asambleja ka këtë rend dite:

1. Të miratojë për zmadhimin e kapitalit me vleren 138,853,725 ( Një̈qind e tridhjetë e tetëmilion e tetëqind e pesedhjete e tremijë e shtateqind e njëzet e pesë) lekë me përfshirjen e transferimit të makinerive dhe pajisjeve nga Ujësjellës Fshat tek Ujësjelles Kanalizime Malësi e Madhe sh.a të viti ushtrimor 2017. Pas këtij veprimi kapitali bëhet 171,273,725 ( Njëqind e shtatëdhjete e njëmilion e dyqind e shtatëdhjete e tremijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë.

2.Të miratojë raportin për shtesë kapitali të znj.Mimoza Frashri e regjistruar në regjistrin publik të I.K.M liçense me nr.124 datë 17.07.1998.

## VENDOSI:

1. Të miratojë për zmadhimin e kapitalit me vleren 138,853,725 lekë me perfshirjen e transferimit të makinerive dhe pajisjeve nga Ujësjellës Fshat tek Ujesjelles Kanalizime Malësi e Madhe sh.a, të vitit ushtrimor 2017. Pas këtij veprimi kapitali bahet 171,273,725 lekë.

2.Të miratojë raportin për shtesë kapitali të znj.Mimoza Frashri e regjistruar në regjistrin publik të I.K.M license me nr.124 datë 17.07.1998, për shtesen e kapitalit i cili behet 171,273,725 lekë dhe që zotërohet totalisht nga "Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe" sh.a.

**KRYETARI I ASAMBLESE**

**Z.TONIN MARINAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE -

***RAPORT PER SHTESE KAPITALI***

***NGA KONTABILIST I MIRATUAR***

***Shoqerise “ Ujesjelles Malesi e Madhe “ Sh.A***

***Adresa : Koplik Malesi Madhe***

*Shtator 2018*

## ***LETER ANGAZHIMI***

*Adresuar: Shoqerise **" Ujesjelles Malesi e Madhe " Sh.A***

*Nga Kontabel i Miratuar Zj Mimoza Kola.*
*Ju keni kerkuar qe ne te vertetojme Bilancin kontabel te shoqerise **" Ujesjelles Malesi e Madhe " Sh.A** per rritje te kapitalit.*

*Kam kenaqesine qe t'Ju konfirmoj se Ne e pranojme dhe e kuptojme kete angazhim nepermjet kesaj letre.*

1) *Auditimi Yne per dhenie sigurie do te kyhet me objektivin per te shprehur nje opinion per saktesine e kerkeses Suaj.*

*Ne do te kryejme auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.*
*Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te marre siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale.Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve te evidencave qe mbeshtesin shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare me objektiv te percaktuar qarte: **shtese kapitali**.*
*Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe cmuarjet e rendesishme te bera nga drejtuesit si dhe vleresimin e pergjithshem te paraqitjes se pasqyrave financiare.*

2) *Ne Ju kujtojme se pergjegjesia per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe te dhenat qe na jane servirur duke perfshire edhe informacionet e dhena eshte e drejtuesve te shoqerise.*

*Si pjese e procesit te auditimit ,Ne kerkojme nga drejtuesit komfirmimin me shkrim ne lidhje me paraqitjet e bera per Ne,persa lidhet me auditimin duke kunderfirmosur shkresen tone.*

3) *Ne presim nje bashkepunim te plote me personelin tuaj dhe Ne kemi besim qe ata do te na bejne te disponueshme cdo lloj regjistrimi,dokumentacioni dhe informacione te tjera qe do te kerkohen ne lidhje me auditimin tone.*

*Marrjen e pakufizuar te informacionit ne funksion te objektit te dhenies se sigurise qe kerkohet per kete raport.*

4) *Kuotat e pageses do te faturohen gjate kryerjes se punes me ore pune dhe tarife orare te miratuar.*

*Shpenzimet ditore te auditit te bera per nevojat e shoqerise do te paguhen nga kjo e fundit.*

5) *Ju lutemi firmoseni dhe na dergoni kopjen qe I bashkengjitet kesaj letre per te treguar se ajo eshte ne perputhje me kuptimin tuaj te marreveshjes per auditimin e pasqyrave financiare.*

*Hartuar nga Kontabilisti i Miratuar*

*Pranuar nga Shoqeria **" Ujesjelles Malesi e Madhe " Sh.A***

*Mimoza Kola*



MIMOZA KOLA
NIPT K 46 5 260 79 0
KONTABEL I MIRATUAR
SHKODER

Date 20 Shtator 2018

**Raport nga Kontabel i Miratuar**
**Mbi verifikimin e shteses se kapitalit per shoqerine" Ujesjelles Kanalizime Malesi e Madhe "sh.a**

***Asamblese se Shoqerise Aksionare***
***Te nderuar Zoterinj***

*Ne ekzekutim te misionit te ngarkuar nga Asambleja e **Shoqerise Aksionare** te shoqerise Suaj per vleresimin e shteses se kapitalit te shoqerise Suaj si Kontabel i Miratuar per vleresimin e ketij kapitali kam kenaqesine t'Ju paraqes raportin si me poshte vijon:*
*Ne vendimin e asamblese date **18 Shtator** Kryetari i Asamblese ka vendosur rritjen e kapitalit te shoqerise me transferimet e makinerive dhe pajisjeve nga Ujesjellesi Fshat te kryer gjate vitit 2017.*

***Objektivat***
*Verifikimi I shteses se kapitalit nga transferimet e makinerive dhe pajisjeve nga Ujesjellesi Fshat te kryer gjate vitit 2017.*

***Baza ligjore***
1) *Ligji 9901 date 14.04.2008"Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"*

***Baza Dokumentare***
2) *Dokumenti ligjor I shoqerise,akt-themelimi,status,pasqyrat financiare te shoqerise.*

*Te d henat per Shoqerine:*
*Shoqeria" **Ujesjelles Kanalizime Malesi e Madhe** "sh.a regjistruar me vendim Gjykate nr. Date 15 Maj 2001.*
*Statusi Juridik"Shoqeri Aksionare"*
*Kapitali Themeltar 32.420.000 lek,I ndare ne 32.420 aksione pjese me vlere nominale 1.000 lek secila.*

***Kryetari i asamblese se ortakeve eshte z. Ndoc Prela.***
*Selia ndodhet ne Koplik Malesi e Madhe*

***Objekti I veprimtarise:*** *Grumbullim dhe shperndarje uji.*
***ARSYEJA DHE MENYRA E VLERESIMIT***
*Kapitali I shoqerise" **Ujesjelles Kanalizime Malesi e Madhe** "sh.a eshte si me poshte:*
*Ne momentin e themelimit ne baze te statutit te shoqerise eshte 32.420.000 (tridhjeteedymilionekaterqindenjezetmije )lek.*

*Kerkohet te behet kapitalizimi I fitimeve si me poshte:*
*Kerkohet te behet shtese kapitali ne vleren **138.853.725** leke.*

**1.** *Me perfshirjen nga transferimet e makinerive dhe pajisjeve nga Ujesjellesi Fshat te kryer gjate vitit 2017*

***PJESEMARRJA NE KAPITALIN THEMELTAR***

*Sipas statusit te shoqerise , administrator I vetem I shoqerise eshte Z. Ndoc Prela. me 100% te kuotave te kapitalit aksionar ekzistues dhe 100% te shteses se kapitalit. Aktualisht kapitali aksionar eshte 32.420.000 (tridhjeteedymilionekaterqindenjezetmije )lek. dhe ndahet ne32.420 aksione me vlere nominale 1.000, leke çdo pjese. Ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare si dhe normat e standartet e profesionit kontabel I Miratuar kam marre te gjithe informacionin e nevojshem per te bere vleresimin e ketyre kontributeve qe lidhen me shtesen e kapitalit te shoqerise"* ***Ujesjelles Kanalizime Malesi e Madhe*** *"sh.a dhe konstatoj si me poshte:*

*3) Ne momentin e themelimit ne baze te statutit te shoqerise kapitali aksionar eshte 32.420.000 (tridhjeteedymilionekaterqindenjezetmije) lek*
*Nga te dhenat e pasqyrave financiare nder vite 2016-2017*
*kemi si me poshte:*

*PASQYRA E KAPITALIT TE VET NDER VITE*

| Nr | Emertimi/Vitet | 2016 | 2017 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kapitali aksionar | 32.420.000 | 171.273.725 | | | |
| 2 | Fitimi i Vitit Ushtrimor | 0 | (20.058.847) | | | |
| 3 | Fitimi/humbja e akumuluar | (16.598.835) | (16.598.835) | | | |
| 4 | Rezerva te tjera | 103.547.421 | 103.547.421 | | | |
| 5 | Shpernd. dividente | | | | | |
| | Shuma totale e kapitalit | 119.368.586 | 238.163.464 | | | |

*Vlera* ***138.853.725*** *leke per te cilen eshte marre vendimi per shtese kapitali perfaqeson*
**1.** *Me perfshirjen nga transferimet e makinerive dhe pajisjeve nga Ujesjellesi Fshat te kryer gjate vitit 2017*

***Shtesa e kapitalit ne total nga*** *32.420.000 qe ishte behet 171.273.725 lek me perfshirjen nga transferimet e makinerive dhe pajisjeve nga Ujesjellesi Fshat te kryer gjate vitit 2017*

***Mbas ketij veprimi kapitali ligjor nga 32.420.000 leke shtohet 138.853.725 lek dhe behet 171.273.725 leke i ndare ne 171.273,725 aksione me vlere nominale 1.000 leke .***

***<u>SI PERFUNDIM</u>***

*Ne shqyrtimin e pergjithshem te dokumentacionit konstatoj se vlera e paraqitur nga shoqeria **<u>" Ujesjelles Kanalizime Malesi e Madhe</u>** "sh.a*
*te pranohet per **138.853.725** leke .*
*pas shteses kapitali behet **171.273.725** lek duke u perbere nga 171.273,725 aksione me vlere nominale 1.000 lek secila pjese.*

*Pas shteses se kapitalit Pasqyra e Kapitalit ne Pasqyrat Financiare do te kete kete format:*

*I SH T E* *31.12. 2016*

| *EMERTIMI I ZERAVE TE KAPITALIT* | *VLERA NE LEK* |
|---|---|
| *KAPITALI AKSIONAR* | *32.420.000* |
| *REZERVA LIGJORE* | |
| *REZERVA TE TJERA* | *103.547.421* |
| *FITIMI I VITIT FINANCIAR* | *0* |
| *FITIME /HUMBJE TE MBARTURA* | *(16.598.835)* |
| ***SHUMA TOTALE E KAPITALIT*** | *119.368.586* |

*B E H E T* *31.12.2017*

| *EMERTIMI I ZERAVE TE KAPITALIT* | *VLERA NE LEK* |
|---|---|
| *KAPITALI AKSIONAR* | *171.273.725* |
| *REZERVA TE TJERA* | *103.547.421* |
| *FITIME/ HUMBJE TE MBARTURA* | *(16.598.835)* |
| *FITIMI /HUMBJE TE VITIT FINANCIAR* | *(20.058.847)* |
| ***SHUMA TOTALE E KAPITALIT*** | ***238.163.464*** |

*HARTOI:*

*Shkoder me 20 /09/ 2018* *KM. Mimoza Frasheri*

MIMOZA KOLA
NIPT K 46526079 Q
KONTABEL I MIRATUAR
SHKODER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALESI E MADHE**

**KESHILLI**

Nr.4855.prot

Koplik më:30/07/2018

Lenda. Dergim Vendimesh të Këshillit të Bashkise Malesi e Madhe

PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER

Bashkangjitur po ju dergojme Vendimin nr 149 datë 25.07.2018 të Këshillit të Bashkise Malesi e Madhe.

Numeri i fleteve të Vendimit është 3 (tre)

Sekretari

Emirjan Hasmujaj

Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALËSI E MADHE**

KESHILLI

**Nr.4855 Prot**

**KOPLIK me 30 /07 /2018**

## VENDIM

**Nr.149, date 25 /07 /2018**

**PER**
**KALIMIN E SISTEMIT TE KANALIZIMEVE NEN ADMINISTRIMIN E UJESJELLES SH.A MAESI E MADHE**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 25/07/2018 ne mbeshtetje te Ligjit 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" , Ligjit 68/ 2017 " Per financat e Vetqeverisjes Vendore ", Ligjin Nr 109/2017 "Per buxhetin e vitit 2018 ", Udhezimit plotesues nr.2 date 19.02.2018 "Per zbatimin e Buxhetit te Vitit 2018 " Ligjit nr.9901 date 14/04/2008 " per tregtaret dhe shoqerite tregtare" , te ndryshuar , VKM-nr.63 date 27.01.2018 " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem , grumbullmin , largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura" , Statutit te Ndermarrjes Sh.a Ujesjelles Malesi e Madhe , Ligji nr.8102 date 28.03.1996 " Per kuadrin rregullator te furnizimit me uje dhe te largimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura" , Keshilli i Bashkise Malesise se Madhe me propozim te Kryetarit te Bashkise me 21 vota pro ;

VENDOSI:

1. Kalimin nen administrim te sistemit te kanalizmeve tek ujesjelles Malesi e Madhe sh.a .
   - KUB Qyteti Koplik me nje vlere prej 7057029 ( Ndertuar ne vitin 2005 )
   - KUZ Qyteti Koplik me nje vlere prej 2472094 (ndertuar ne vitin 2001 )
   - KUZ Lagja Llazan me nje vlere prej 1978488 (Ndertuar ne vitin 2006
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
4. U miratua më datë 25.07.2018.
5. U shpall me datë 27.07.2018.

**SEKRETAR I KESHILLIT**

**Emirjan Hasmujaj**

**KRYETARI I KESHILLIT**

**Ilir Halaj**

Adresa Koplik Qender tel 021122650/2651 e-mail:bashkia malesiemadhe@hotmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALËSI E MADHE

SEKTORI FINANCES

**Nr.4734 Prot**

**Koplik,me 20/ 07/2018**

**LENDA : Kerkese per kalimin e sistemit te kanalizimeve ne Ujesjelles SH.A Malesi e Madhe**

**DREJTUAR: KESHILLIT BASHKIAK MALESI E MADHE**

Sistemi i kanalizimeve eshte menaxhuar dhe admninistruar nga Bashkia e Malesise se Madhe . Me VKM-nr.63 date 27.01.2016 " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem , grumbullmin , largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura" , Statutit te Ndermarrjes Sh.a Ujesjelles Malesi e Madhe , ky sistem duhet ti kaloje nen administrim Ujesjelles Sh.A Malesi e Madhe.

Kerkojme nga ana juaj kalimin e kanaleve te ujrave te bardha e te zeza te administruara nga Bashkia deri ne keto momente si me poshte .

- KUB Qyteti Koplik me nje vlere prej 7057029 ( Ndertuar ne vitin 2005 )
- KUZ Qyteti Koplik me nje vlere prej 2472094 (ndertuar ne vitin 2001 )
- KUZ Lagja Llazan me nje vlere prej 1978488 (Ndertuar ne vitin 2006 )

Bashkengjitur po ju dergojme Fletet e Inventarit te Kanaleve te ujrave te Bardha e te Zeza.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin tuaj

**KRYETARI**

**TONIN MARINAJ**

Konceptoi : Nadire Duka (Insp. Finance )
Miratoi : Altin Rrukaj ( Pergj. Finance )